



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A.

Nr. 1775/12 Prot

Tiranë, më 21/8 / 2026

Lënda: Njoftim për fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive.

ORGANIZATAVE PËRFAQËSUESE SINDIKALE

Baza ligjore: Neni 50 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 159 e vijues i Ligjit Nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë” (i ndryshuar), si dhe kërkesa Nr.050 Prot., datë 01.06.2026 e Federatës së Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë, me lëndë “*Kërkesë për ri-nënshkrim të Kontratës Kolektive (FSPTTSH-së)*”

Me qëllim mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave, interesave ekonomike, profesionale dhe sociale të punonjësve, lidhur me rregullimin e marrëdhënies së punës dhe ushtrimin e veprimtarisë sindikaliste, si dhe duke marrë shkas nga kërkesa për lidhjen e kontratës kolektive pranë “Posta Shqiptare”, sh.a., nga ku synojmë garantimin e një procesi transparent dhe jodiskriminues, sigurimin e besimit për këtë procedurë, si dhe trajtimin e barabartë të organizatave sindikale që mund të shprehin interes për lidhjen e marrëveshjes kolektive të punës, Shoqëria “Posta Shqiptare”, SH.A.:

Fton të gjithë Organizatat Sindikale të interesuara të paraqesin pranë Drejtorisë së Përgjithshme Posta Shqiptare sh.a., në adresën: **Rruga “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë (Zyra e Protokollit)**, brenda 2 (dy) javëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi:

1. Kërkesën me shkrim për fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive;
2. Statutin e Sindikatës;
3. Aktin e Themelimit;
4. Vendimin e Gypatës lidhur me regjistrimin si person juridik të organizatës;
5. Treguesit mbi përfaqësueshmërinë. (në formën e një vërtetimi noterial, ku noteri vërteton numrin e anëtarëve të organizatës sindikale, në bazë të kuotizacioneve të paguara gjatë dy vjetëve të fundit ose deklarimeve, me shkrim ose me gojë, të punëmarrësve anëtarë);

Të gjithë dokumentat, duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti konsiderohet si kusht për skualifikim.

Në përfundim të afatit 14 ditor (katërmëdhjetë ditë kalendarike), Grupi i Punës do të mbyll fazën e pranimit të kërkesave dhe dokumentacionit shoqërues. Çdo kërkesë e ardhur pas përfundimit të afatit më sipër nuk do të merret parasysh.

Më tej do të procedohet, me publikimin e kërkesave duke i afishuar në vënde të dukshme, në ambientet e Drejtorisë së Filialeve / Degëve dhe Zyrave Postare.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

